

VENDIM
Nr.172, datë 28.3.2007

PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “ROT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË E MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “WONDER” SHA, PËR HIDROCENTRALIN E BOGOVËS, TË MIRATUAR ME VENDIM NR.609, DATË 11.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit të formës “ROT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Wonder” sh.a., për hidrocentralin e Bogovës, të miratuar me vendim nr.609, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr.609, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe në tekstin e marrëveshjes bazë të koncesionit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe energjetikës dhe shoqërisë “Wonder” sh.a., për hidrocentralin e Bogovës, fjalët “...Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë...” Zëvendësohen me “...Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SHITESË KONCESIONI
PËR HIDROCENTRALIN BOGOVË-SKRAPAR

Në Tiranë, sot më datë 15.3.2007, Palët:

OSHA e përfaqësuar nga z. Zamir Stefani me autorizimin nr.387/3, datë 22.2.2007 të METE-s

dhe

shoqëria “Wonder” sh.a. Tiranë, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm i saj z.Vasil Gjika,

me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë marrëveshje shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit e formës ROT, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “Wonder” sh.a. Tiranë, për rehabilitimin e hidrocentralit të Bogovës në Skrapar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 11.9.2003.

HYRJE

Duke pasur parasysh që në marrëveshjen ekzistuese të koncesionit ka mangësi për të

realizuar monitorimin e duhur të ecurisë së objektit të koncesionit, bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nene të marrëveshjes.

Palët bien dakord që në marrëveshjen bazë të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 11.9.2003, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pas titullit, rreshti i parë i paragrafit të parë të marrëveshjes së koncesionit, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “Wonder” sh.a. Tiranë, për rehabilitimin e hidrocentralit të Bogovës në Skrapar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 11.9.2003, ndryshon si më poshtë:

“Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”.

Neni 2

Në nenin 4 “Detyrimet dhe të drejtat e koncesionarit”, te “Të drejtat e koncesionarit”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Koncesionari ka të drejtë të rrisë kapacitetin e prurjeve të ujit, duke përfshirë edhe burime të reja, përveç burimeve ekzistuese”.

Neni 3

Pas nenit 8, të shtohet një nen i ri me titull “Përdorimi i ujit” me këtë përmbajtje:

- “Për shfrytëzimin racional të ujit të burimeve të Bogovës, ndërmarrja e ujësjellësit Berat është e autorizuar të hartojë me koncesionarin një marrëveshje përdorimi të këtyre ujërave, ku të përcaktohen kuotat e shfrytëzimit nga të dyja Palët, si dhe mënyra e rregullimit të tyre.”.

- “Për përdorimin me efikasitet të ujit, ndërmarrja e ujësjellësit Berat, në bashkëpunim me koncesionarin, autorizohen të hartojnë projektin për ndërtimin e një stacioni pompimi në dalje të bjefit të poshtëm të HEC-it të Bogovës, me qëllim dërgimin e ujit në tubacionin kryesor të ujësjellësit.”.

Neni 4

Në nenin 10 “Programi i punimeve”,

- pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“Afati i përfundimit të investimeve, i përcaktuar në anekset 2 dhe 3, shtyhen deri në datën 31.12.2006.”.

- Pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2007 deri në fund të periudhës koncesionare është jo më pak se prodhimi i përcaktuar në aneksin 2 në kolonën: viti 2005-2006.

Ndryshimi i programit vjetor të prodhimit mund të bëhet me miratim të OSHA-së, në rastet e ndryshimit të parametrave teknikë të objektit.”.

Neni 5

Në nenin 14 “Kontrolli i përgjithshëm”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“OSHA ushtron kontroll në objektin e dhënë me koncesion edhe gjatë kohës së shfrytëzimit, pas përfundimit të rehabilitimit të përcaktuar në këtë marrëveshje. Kontrolli kryhet nga persona të autorizuar nga OSHA-ja me qëllim verifikimin e shfrytëzimit dhe prodhimit, sipas parametrave teknikë të objektit të dhënë me koncesion, si dhe kryerjen e remonteve të parashikuara në udhëzimet e shfrytëzimit të pajisjeve.”

Neni 6

Në nenin 20 “Zbatimi i projektit” pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf i ri me këtë

përmbajtje:

“Me përfundimin e zbatimit të projektit rehabilitues mbi objektin e koncesionit, koncesionari është i detyruar që në fund të çdo tremujori, dhe sa herë e kërkon OSHA-ja, të raportojë me shkrim mbi ecurinë e punës në objekt, sipas një formulari që do të dërgohet nga OSHA-ja.”.

Neni 7

Në nenin 22 “Sanksionet”

- në paragrafin e dytë, fjalët “pika 1” zëvendësohen me fjalët “pika 2”;

- pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rast mosrealizimi të programit të prodhimit, të përcaktuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, koncesionari penalizohet me 0.01% të vlerës së prodhimit të parealizuar për periudhën raportuese.”.

Neni 8

Marrëveshja shtesë e koncesionit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet e përshkruara në nenet 1-8 më lart, kanë fuqi për të dyja Palët.

Nenet e tjera të marrëveshjes bazë nuk kanë ndryshuar.

Marrëveshja shtesë e koncesionit mbahet në 7 (shtatë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja Palët.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
PËRFAQËSUESI ME AUTORIZIM
Zamir Stefani

Për koncesionarin
Shoqëria “Wonder” sh.a.
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Vasil Gjika